

UDHËZIM
Nr. 4, datë 31.3.2026

PËR KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E REGJISTRIT TË KONTRATAVE “PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË AKUAKULTURËS”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e kërkesave për krijimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës.

2. Regjistri i kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës krijohet, ruhet, mirëmbahet dhe përditësohet nga drejtoria përgjegjëse në ministri për hartimin e politikave në akuakulturë, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Regjistri i kontratave për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës krijohet dhe administrohet në format të integruar elektronik dhe përmban të dhënat, si vijon:

- a) numrin dhe datën e nënshkrimit të kontratës;
- b) emrin e subjektit fizik/juridik;
- c) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);
- ç) emrin e përfaqësuesit ligjor të subjektit fizik/juridik;
- d) kontaktet për komunikim (*email/tel*);
- dh) objektin e kontratës (përcaktimin e llojit të aktivitetit të akuakulturës);
- e) adresën e vendit, ku zhvillohet veprimtaria e akuakulturës;
- ë) llojin e sipërfaqes së dhënë (tokësore/ujore) dhe koordinatat gjeografike;
- f) sipërfaqen totale të dhënë për përdorim;
- g) kohëzgjatjen e kontratës (datat përkatëse të fillimit e përfundimit);
- gj) të dhënat mbi investimet (investimet e parashikuara/investimet e realizuara);
- h) sasinë e prodhimit;
- i) numrin minimal të punësimit;
- j) depozitimet e deklarimeve statistikore;
- k) pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës;
- l) statusi i kontratës (vendimet për pezullim, ndryshim, zgjidhje ose ndërprerje).

4. Regjistrimi i kontratës kryhet brenda 5 ditëve pune nga data e nënshkrimit të saj.

5. Plotësimi dhe përditësimi i regjistrit kryhet nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave të akuakulturës.

6. Të dhënat duhet të jenë të sakta, të verifikuara dhe të mbështetura në dokumentacion zyrtar.

7. Regjistri përditësohet çdo herë që rezultojnë të dhëna të reja nga:

- a) raportimet e subjektit;
- b) aktet e monitorimit dhe inspektimit;
- c) pagesat vjetore të kryera;
- ç) vendimmarrjet administrative të MBZHR-së.

8. Për çdo ndryshim mbahet procesverbal dhe materiali dokumentohet zyrtarisht.

9. Të dhënat në regjistër ruhen për një periudhë jo më pak se 5 vjet pas përfundimit të kontratës.

10. Drejtoria përgjegjëse në ministri për hartimin e politikave në akuakulturë kryen verifikime periodike mbi përputhshmërinë e të dhënave në regjistër me dokumentet origjinale.

11. Drejtoria përgjegjëse në ministri për hartimin e politikave në akuakulturë harton një raport vjetor mbi përmbajtjen e regjistrit.

12. Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të gjitha kontratat ekzistuese të lidhura përpara miratimit të këtij udhëzimi do të regjistrohen në regjistrin elektronik.

13. Ngarkohet Drejtoria e Politikave, Strategjive dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUIQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

SHTOJCA 1

Shtojca e sipërpërmendur në pikën 2 të udhëzimit, që do të jetë një tabelë e ndërtuar në *Excel*, me të dhënat, si më poshtë:

| Nr. | Nr. i kontratës | Data e kontratës | Emri i subjektit | NUIS | Përfaqësuesi ligjor | Objekti i kontratës (Lloji i aktivitetit) | Adresa e veprimtarisë | Lloji i sipërfaqes (tokësore/ujore) | Koordinatat gjeografike | Sipërfaqja (ha/ m²) | Afati i kontratës – Fillimi – Përfundimi | Të dhënat mbi investimet | Sasia e prodhimit | Nr. minimal i punësimit | Deklarime statistikore (po/jo/data) | Pagesa për aktivitetin (Data/Vlera) | Statusi i kontratës (aktive/pezulluar/zgjidhur/ndërprerë/mbaruar) | Kontaktet për komunikim (email/tel.) | Shënime |

Nr.	Nr. prot.	Data e kontratës	Emri i subjektit	NUIS	Përfaqësuesi ligjor	Objekti i kontratës (Lloji i aktivitetit)	Adresa e veprimtarisë	Lloji i sipërfaqes (tokësore/ujore)	Koordinatat gjeografike	Sipërfaqja (ha/ m ²)	Afati i kontratës - (fillim - përfundim)	Të dhënat mbi investimet	Sasia e prodhimit	Nr. minimal i punësimit	Deklarime statistikore (po/jo/data)	Pagesa për aktivitetin (Data/Vlera)	Statusi i kontratës (aktive/pezulluar/zgjidhur/ndërprerë/mbaruar)	Kontaktet për komunikim (email/tel.)	Shënime
-----	-----------	------------------	------------------	------	---------------------	---	-----------------------	-------------------------------------	-------------------------	----------------------------------	--	--------------------------	-------------------	-------------------------	-------------------------------------	-------------------------------------	---	--------------------------------------	---------